



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 19, datë 28/06/2018

PËR

“MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË STUDENTËVE QË KRYEJNË NJË PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË TË NJËJTIN PROGRAM STUDIMI PËR TË CILIN JANË DIPLOMUAR MË PARË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 85, nenin 89 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; pikën 3 të Raportit të Grupit të Punës “Mbi verifikimin e përshtatshmërisë së programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetet e Universitetit të Arteve” me nr. 6838, datë 10.07.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, i ngritur me Urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 616, datë 30.12.2016; si dhe shkresën e Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik me nr. 163 prot., datë 06.06.2018 “Për pagesën e tarifës së studimit të disa studentëve që ndjekin program të dytë studimi në Fakultetin e Artit, pasi e diskutoi,

VENDOSI:

1. Fakultetet e Universitetit të Arteve, të ngrejnjë komisionet e ekuivalentimit për të gjithë studentët të cilët kryejnë një program të dytë studimi, në të njëjtin program studimi për të cilin janë diplomuar më parë, në ciklin e dytë të studimeve master.
2. Ti propozojë Bordit të Administrimit që detyrimi financiar i studentëve ndaj UART për pagesën e tarifës së shkollimit për program të dytë studimi, të jetë vetëm pagesa e krediteve për lëndët që përcaktohen nga komisioni i ekuivalentimit.
3. Studentët i nënshtrohen tarifave të miratuara nga strukturat e UART për konkurrim dhe regjistrim për vitin akademik që ato aplikojnë.
4. Ti propozojë Bordit të Administrimit që nga pika 2 e këtij vendimi të përjashtohen studentët e shkëlqyer, në zbatim të nenit 85, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
5. Ky vendim ti dërgohet për miratim Bordit të Administrimit.
6. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare të UART.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA